



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 10639 Prot

Fier, me 19.09.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 92, Datë 19.09.2025

“Për autorizimin e ekzekutivit të Bashkisë Fier të nënshkruaj marrëveshjen e bashkëpunimit për administrimin e përkohshëm të objektit “Depo uji 200 m³, Mbrostar Ura” nga “Shoqëria Rajonale e ‘Ujësjetës-Kanalizime Fier’ Sh.A.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, pika ‘1’ e nenit 23, “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, pika ‘3’ e nenit 33 “Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike”; pikën ‘k’ të nenit 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”; Ligjit nr. 8102/1996 “Për sistemin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të përdorura”, i ndryshuar; Ligji nr. 8102/1996, Ligji nr. 8743/2001, Kodi Civil. Bashkia Fier;

Duke u njohur me relacionin e ekzekutivit të Bashkisë Fier dhe dokumentacionin shoqëruar (kontrata nr. 10653/24, procesverbal kolaudimi 04.02.2025, certifikata e marrjes së përkohshme 04.02.2025).

PROPOZOJMË:

1. Të autorizohet ekzekutivi i Bashkisë Fier të nënshkruaj marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Fier dhe “Shoqërisë Rajonale të ‘Ujësjetës-Kanalizimeve Fier’ Sh.A, për dhënien në administrim të përkohshëm të objektit “Depo uji 200 m³, Mbrostar Ura”.
2. Akt- Marrëveshja e bashkëpunimit të ketë si qëllim të administrojë dhe përdorë objektin për qëllime furnizimi me ujë të komunitetit, duke marrë përsipër mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tij gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm nga “Shoqëria Rajonale e ‘Ujësjetës-Kanalizime Fier’ Sh.A.
3. Marrëveshja e bashkëpunimit do të jetë në fuqi deri në përfundimin e procedurës së dorëzimit përfundimtar të objektit dhe marrjen e vendimit të posaçëm nga Këshilli Bashkiak Fier për administrimin afatgjatë.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier për nënshkrimin e marrëveshjes dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Drejtoria e Programimit,
Kontrollit të Punëve Publike dhe Investimeve**
Drejtori: Silvana Basha

Drejtoria Juridike
Drejtori: Esmeralda Kapllanaj

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave
Drejtor: Arbion Behari

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Drejtor: Pranvera Çina

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Zv/Kryetar
Vasil Bregu